

HIGJENA

1. Higjena është shkencë që studion :
 - a) Parandalimin dhe promovimin e shëndetit
 - b) Patologjitë e njeriut.
 - c) Ligjet e natyrës.

2. Të gjitha kushtet që kanë të bëjnë me jetën dhe me zhvillimin e një personi përbëjnë:
 - a) Mjedisin
 - b) Natyrën.
 - c) Shëndetin.

3. Mikroorganizmat janë:
 - a) Gjallesa mikroskopike që rriten, shumohen dhe ngordhin.
 - b) Gjallesa gjigande që rriten, shumohen dhe ngordhin.
 - c) Gjallesa më të përshtatshme që rriten, shumohen dhe ngordhin në laborator apo terren.

4. Sterilizimi është:
 - a) Shkatërrimi i të gjitha mikroorganizmave të gjalla në ambient.
 - b) Shkatërrimi i të gjitha mikroorganizmave të gjalla në mjetet apo sende.
 - c) Shkatërrimi i të gjitha mikroorganizmave të gjalla në ambient, sende dhe mjete

5. Asepsia është:
 - a) Prezenca e mikroorganizmave.
 - b) Mungesa e mikroorganizmave.
 - c) Lufta kundër mikroorganizmave.

6. Infeksioni është aftësia që një mikrob ka:
 - a) Për të hyrë në organizmin e njeriut.
 - b) Për t'u shumuar në organizmin e njeriut.
 - c) Për të shkaktuar dëme në organizmin e njeriut.

7. Denzifikimi i duarve kryhet pamvarsisht nga larja e duarve:
 1. Po.
 2. Jo.
 3. Nuk ka rëndësi.

8. Sa kohë zgjat efekti i dezinfektantëve të veglave në salla kirurgjikale:

- a) 30 minuta.
- b) 8 orë.
- c) 48 orë.

9. A rrezikon transfuzioni i gjakut në pacientët për mundësinë e infektimit të tyre me hvb, hvc, hiv në mjedisin ku ju punoni:

- a) Po.
- b) Jo.
- c) Ndoshta.

10. Para realizimit të procedurave invazive, është e domosdoshme:

- a) Larja kirurgjikale e duarve.
- b) Larje normale.
- c) Vetëm një dezinfektim të duarve me një dezinfektant.

11. Për realizimin e procedurave invazive që kërkojnë një asepsi kirurgjikale përdorim:

- a) Doreza sterile.
- b) Doreza jo sterile.
- c) Dy palë doreza jo sterile një mbi një.

12. Gjatë mjekimit të plagëve kirurgjikale tek disa pacientë dorezat sterile duhet të :

- a) Ndërrohen pas përdorimit të çdo pacient,
- b) Nuk është e nevojshme të ndërrohen.
- c) Nuk është e nevojshme të vishen.

13. Përdorimi i maskës është i nevojshëm gjatë:

- a) Realizimit të teknikave që kërkojnë asepsi kirurgjikale.
- b) Pastrimit të ambientit të punës.
- c) Gjatë informacionit që i japim pacientëve.

14. Përdorimi i maskave gjatë dhënies së kujdesjeve mbrojnë nga infeksionet:

- a) Pacientët.
- b) Vetë personelin infermier.
- c) Të dy njëkohësisht.

15. Maska duhet të vendoset:

- a) Pasi të kemi larë duart.
- b) Para larjes së duarve.
- c) Nuk ka rëndësi.

16. Nëse gjatë një procedure invazive ne kontaminohemi me likide biologjike të pacientit (gjak, urinë, sekrecione, etj), në këtë rast përparësja duhet:

- a) Ndërruar.
- b) Fshirë në moment dhe vazhdojmë punën.
- c) Asgjë nga këto të dyja.

17. Rendit sipas rradhës planifikimin e kujdesjeve infermierore:

- a) Aksionet që ndërmerret infermieri.
- b) Përcaktimi i objektivave.
- c) Mbledhja e të dhënave (informacionet) të pacientit.
- d) Analiza e këtyre informacioneve.
- e) Vlerësimi i aksioneve (gjendjes së pacientit).

18. Rendit sipas rradhës veprimet gjatë tualetit të përgjithshëm të pacientit.

- a) Syte, qepallat (1)
- b) Krahët, duart, sqetullat.(3)
- c) Këmbët (7)
- d) Kurrizi (8)
- e) Fytyra(2)
- f) Krahbarori(4)
- g) Barku(6)
- h) Regioni perineal(9).

19. Tek pacientët me dekubituse cila nga këto aksione nuk është e rëndësishme.

- a) Ndërrimi i pozicionit të pacientit çdo 2-3 orë.
- b) Masazh i lehtë dhe ushtrime.
- c) Mbajtja pastër dhe e thatë e lëkurës.
- d) Respektimi i orarit të mjekimit.

20. Rendit sipas rradhës hapat që duhet të ndërmarrësh gjatë pastrimit të një instrumenti pasi ke kryer një mjekim plage të pastër ose të kontaminuar.

- a) Larja me ujë të ngrohtë dhe me sapun (eliminon papastërtinë).
- b) Pastrimi me produkte abraziv kur është e nevojshme.
- c) Shpëlarja e materialit me ujë të ftohtë (për eliminimin e materialeve organike).
- d) Shpëlarja me ujë dhe tharja e mirë e materialit.

e) Sterilizimi sipas nevojës.

21. Shpërlarja instrumentit pas një mjekimi plage kirurgjikale me ujë të ftohtë është e domosdoshme sepse:

- a) Realizon sterilizimin e materialit.
- b) Realizon dezinfektimin e materialit.
- c) Realizon eliminimin e materialeve organike nga instrumenti.

22. Larja me sapun dhe me ujë të ngrohtë është e rëndësishme sepse:

- a) Realizon sterilizimin e instrumentit.
- b) Realizon dezinfektimin e instrumentit.
- c) Realizon eliminimin e papastërtisë.

23. Gjatë autoklavimit infermieri duhet të vendosë materialet :

- a) Në mënyrë të ngjeshur.
- b) Në mënyrë të tillë që avujt të qarkullojnë lirshëm përreth çdo pakete.
- c) Nuk ka rëndësi se si i vendosim vetëm të realizohet sterilizimi.

24. Pas përdorimit të instrumentave gjatë mjekimit të plagëve cili është vendi më i përshtatshëm për të depozituar këto instrumenta:

- a) Në një bacinelë të thatë.
- b) Në një bacinelë me ujë të patër dhe të bollshëm.
- c) Në koshin e mbeturinave spitalore.

25. Rendit sipas rradhës hapat gjatë teknikave të larjes së duarve.

- a) Laj duart dhe parakrahët deri te bërryli me ujë të bollshëm dhe sapun.
- b) Bëj fërkimin ndërmjet gishtërinjve.
- c) Përvish mëngët.
- d) Shpëlaji me ujë të rrjedhshëm.
- e) Pastro thonjtë.
- f) Thaji mirë duart.
- g) Përsërite 3-4 herë larjen me ujë dhe sapun.

26. Cila nga këto nuk është e saktë. Maskat përdoren për:

- a) Filtrimin e ajrit gjatë ekspirimit dhe inspirimit.
- b) Eliminimin e përhapjes së mikro-organizmave gjatë mjekimit të plagëve.
- c) Fiksimin e mikroorganizmave.

27. Përpara një interventi kirurgjikal, fusha operatore denzifektohet :

- a) Një javë para.
- b) Një ditë para.
- c) Një muaj para.
- d) Nuk denzifektohet fare.

28. Larja e duarve duhet të bëhet:

- a) Para çdo kujdesje që jep te pacienti.
- b) Pas çdo kujdesje që jep te pacienti.
- c) Para dhe pas çdo kujdesje që jep te pacienti.

TË TJERA RRETH SHËNDETIT

1. Shëndeti është:
 - a) Një mungesë sëmundje.
 - b) Gjendje fizike, sociale dhe mendore e njeriut.
 - c) Mireqënia e njeriut.

2. Sëmundja është :
 - a) Prania e nje procesi patologjik.
 - b) Dëmtimi i një funksioni fizik, social, emocional i njeriut.
 - c) Një simptomë.

3. Temperatura zakonisht shoqëron një:
 - a) Sëmundje emocionale.
 - b) Sëmundje Infektive.
 - c) Asnjë nga të dyja.

4. Septicemia diagnostikohet me anë të :
 - a) Hemokulturës.
 - b) Radioskopisë së pulmonit.
 - c) Bilancit bio-kimik.

5. Stresi është një gjendje e reagimit të organizmit kur ekuilibri i tij kercenohet :
 - a) Nga një agresor i çfardoshëm fizik, psiqik, emocional, social.
 - b) Nga një lëndëëkimike.
 - c) Nga një aksident automobilistik.

6. Symtiomat janë :
 - a) Provë e një procesi të sëmundjes ose një disfunkcionim I një organi.
 - b) Aplikimi I terapisë te pacienti.
 - c) Dhënia e ndihmës së parë te pacienti.

7. Pritja e pacientit në kohën e shtrimit në një shërbim spitalor konstiston në :
 - a) Përshëndetjen dhe informimin që i japim pacientit.
 - b) Realizimin e terapisë.
 - c) Kryerjen e ekzaminimeve të ndryshme diagnostikuese.

8. Gjatë një aksidenti zjarri në pavion cilat nga këto masa nuk është e nevojshme.
 - a) Evakuimi i pacientëve.
 - b) Lajmërimi i zjarrfikësave.
 - c) Ulja e ventilimit.
 - d) Përdorimi i ujit për të shuar zjarrin.

9. Gjej gabimin që një infermier mund të ketë bërë gjatë një operimi.

- a) Observon me kujdes gjakderdhjen.
- b) Observon me kujdes parametrat jetësore.
- c) Nr i kompresave që janë përdorur te pacienti nuk është në rregull.
- d) Informon pacientin që po operohet.
- e) Nuk informon pacientin.